

NJOFTIM PUNE

SPAR Albania është pjesë e BALFIN Group dhe drejton rrjetin më të madh të shitjeve ushqimore me pakicë me të drejtën e ekskluzivitetit të emrit “**SPAR**”.

Balkan Finance Investment Group, BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Zvicër, Kroaci dhe Holandë, me afërsisht 5,200 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me shumicë dhe pakicë, sistemin bankar, menaxhimin e asetëve, mediat dhe logjistikën. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

Pozicioni: Specialist/e Finance

Departamenti: Financë

Vendodhja: Zyra Qëndrore

Detyrat bazë dhe qëllimi i pozicionit:

- Financieri është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të detyrave të tij/saj në përputhje me politikën e përgjithshme të kompanisë.

Përgjegjësitë kryesore:

- Kontrolli i shitjeve ditore në sistem;
- Rakordimi i shitjeve të dyqaneve me arkëtimet;
- Manaxhimi i pagesave në format e ndryshme si Cash, Bankë, Voucher dhe mënyra të tjera pagese;
- Kontrolli i kursit të kembimit për marketet;
- Përgatitja dhe kontrolli i librit të shitjeve me bazë mujore;
- Kontrolli i Gift Card të përdorura në markete;
- Rakordimi i klientëve për pagesat cash dhe me transferte bankare;
- Ndjekja e arkëtimeve të klientëve;
- Raporte të ndryshme të kërkuara nga menaxhimi;

Kërkesat:

Edukimi: Arsim i lartë, profili Ekonomik.

Eksperiencat e punës: Të ketë eksperiencë në këtë profil minimum 2 vite.

Kualifikime të tjera:

- Aftësi kompjuterike të paketës Microsoft Office;
- Njohuri të mira të gjuhës Angleze

Aftësi të tjera:

- Aftësi të shkëlqyera në menaxhimin e kohës dhe aftësi për të përcaktuar prioritetet gjatë ngarkesës së punës.
- Aftësi për të punuar në skuadër;

Mënyra e aplikimit*: Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV e tyre së bashku me letër motivimi në adresën e e-mailit hr@spar.al duke përcaktuar në subjekt pozicionin, online nëpërmjet faqes së Web-it Spar.al, ose nëpërmjet postës në adresën: SPAR Tirana East Gate (TEG), Rruga Nacionale Tiranë-Elbasan, Farkë (Lundër), Tiranë, Shqipëri.

Afati i dorëzimit: 10/02/2023

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr .9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*